

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës:

Pml.Kzz 246/2014

(PPRKR Nr. 47/2013 Gjykata Themelore në Prishtinë)

Data:

15 dhjetor 2014

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova (kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese), gjyqtarja e EULEX-it Esma Erterzi dhe Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Emine Mustafa si anëtare të kolegjit, dhe Zyrtarja ligjore e EULEX-it Kerry Kirsten Moyes si procesmbajtëse, në lëndën penale me numër PPRKR Nr. 47/2013 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë:

AK1, në paraburgim prej 28 tetorit 2013,

AN, në paraburgim prej 28 tetorit 2013;

et al

të dyshuar për veprat penale në vijim:

Krim i organizuar në shkelje të nenit 283, paragrafit 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), në lidhje me veprën penale **Detyrim** në shkelje të nenit 340, paragrafit 2 të KPRK-së;

Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, në shkelje të nenit 374, paragrafit 1 të KPRK-së;

Arben Neziri gjithashtu dyshohet edhe për veprën penale **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge**, në shkelje të nenit 273, paragrafit 1 të KPRK-së;

*Duke vepruar lidhur me kërkesën e përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur më 4 dhjetor 2014 nga avokatët mbrojtës Destan Rukiqi dhe Ymer Osaj në emër të pandehurve **AK1** dhe **AN** kundër aktvendimit të gjyqtares së procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Prishtinë PPRKR. Nr. 47/2013 të datës 12 nëntor 2014 mbi vazhdimin e paraburgimit deri më 24 dhjetor 2014;*

Pas shqyrtimit të përgjigjes në kërkesë nga Prokurori i Shtetit KMLP.III. nr. 55/14 të paraqitur më 9 dhjetor 2014;

Pas këshillimit dhe votimit më 15 dhjetor 2014;

Sipas nenit 418 dhe neneve 432-441 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së)

lëshon këtë

AKTGJYKIM

- 1. Kërkesa e përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokatët mbrojtës Destan Rukiqi dhe Ymer Osaj në emër të pandehurve AK1 dhe AN kundër aktvendimit të gjyqtares së procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Prishtinë PPRKR. Nr. 47/2013 të datës 12 nëntor 2014 mbi vazhdimin e paraburgimit deri më 24 dhjetor 2014, refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Aktvendimi i gjyqtares së procedurës paraprake, vërtetohet.**

ARSYETIM

1. Historia e procedurës

1.1. Më 6 mars 2013, Prokurori Special ka lëshuar aktvendimin për fillimin e hetimit kundër të pandehurve (dhe **AK2**). Të gjithë të pandehurit janë arrestuar më 28 tetor 2013, dhe në të njëjtën ditë Prokurori Special ka paraqitur kërkesën për paraburgim kundër të gjithë tre të pandehurve. Hetimi është zgjeruar më tutje duke përfshirë të pandehur të tjerë.

1.2. Masa e paraburgimit është vazhduar disa herë për të gjithë të pandehurit. Më 24 tetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë ka pranuar kërkesën e PSRK-së dhe ka lëshuar duke vazhduar më tutje paraburgimit për të gjithë të pandehurit për dy (2) muaj deri më 24 dhjetor 2014. Të pandehurit janë ankuar.

1.3. Më 6 nëntor 2014, Gjykata e Apelit ka lëshuar aktvendimin duke e kthyer lëndën në rishqyrtim te gjyqtari i procedurës paraprake. Gjyqtarja e procedurës paraprake ka rishqyrtuar lëndën dhe ka lëshuar aktvendimin e datës 12 nëntor 2014 duke vazhduar paraburgimin kundër të gjithë të pandehurve deri më 24 dhjetor 2014. Të pandehurit janë ankuar përsëri.

1.4. Më 21 nëntor 2014, Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesat e paraqitura në emër të **AK1** dhe **AN** si të pabazuara (dhe ka hedhur poshtë ankesën e paraqitur në emër të **AK2** si të paafatshme), dhe ka vërtetuar vendimin e gjyqtares së procedurës paraprake.

1.5. Më 4 dhjetor 2014, avokatët mbrojtës Destan Rukiqi dhe Ymer Osaj kanë paraqitur kërkesë të përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të **AK1** dhe **AN**. Më 9 dhjetor 2014, Prokurori i Shtetit ka paraqitur përgjigjen.

2. Parashtrësit e palëve

2.1. Avokatët mbrojtës pohojnë se gjyqtarja e procedurës paraprake ka dështuar që të jap arsye të kënaqshme dhe të qarta për të vërtetuar se janë përmbushur kushtet për vazhdimin e paraburgimit për më tepër se një vit, në pajtim me nenin 190 (4) të KPP-së. Vazhdimi i paraburgimit mund të bëhet vetëm pas shkaqeve bindëse dhe të bazuara që bëjnë të besojmë se ekziston rreziku publik apo kërcënimi i dhunës nëse i pandehuri lirohet në fazën e procedurës paraprake. Kjo nuk është arsyetuar dhe është përjashtuar çdo mundësi e rrezikut publik apo kërcënimit të dhunës. Publiku nuk ka treguar fare interesim për këtë lëndë. Prokuroria gati asnjëherë nuk ka dëshmuar se kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm në mënyrë që të shpejtohen hetimet sipas nenit 191 (1) në lidhje me nenin 185 (2) të KPP-së. Kanë kaluar muaj pa asnjë veprim hetimor, dhe vonesat janë evidente, që shkelin nenin 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. PSRK-ja dhe gjyqtarja e procedurës paraprake nuk kanë respektuar vërejtjet dhe sugjerimet e bëra nga Gjykata e Apelit, dhe më e keqja është se Gjykata e Apelit ka ndryshuar qëndrimin e vet në vendimet e saj. Avokatët mbrojtës propozojnë që aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet dhe të pandehurit **AK1** dhe **AN** të lirohen për tu mbrojtur në liri, ose që masa e paraburgimit të zëvendësohet me një masë më të butë sipas nenit 173 (1) të KPP-së.

2.2. Prokurori i Shtetit pohon se edhe Gjykata Themelore edhe Gjykata e Apelit kanë vlerësuar drejtë se ekziston baza ligjore për masën e paraburgimit sipas nenit 187 (1) të KPP-së. **AK1** ka leje të përhershme qëndrimi në Austri dhe duke pasur parasysh peshën e veprave penale dhe dënimin eventuale për veprat penale, vazhdimi i paraburgimit është i arsyeshëm. Të pandehurit mund të ndikojnë në dëshmitarë dhe të bashkakuzuar për faktin se hetimet janë zgjeruar dhe është zbatuar mundësia e veçantë hetimore, dhe këto rrethana tregojnë se nëse të pandehurit lirohen ata mund të ndryshojnë, fshehin apo shkatërrojnë provat. Gjykata e Apelit ka shqyrtuar drejtë peshën e veprave penale, rrethanat dhe ambientin në të cilin janë kryer veprat penale, karakteristikat personale të të pandehurve si dhe mënyrën e kryerjes së veprave penale. Ai propozon që kërkesa të refuzohet.

3. Gjetjet e kolegjit

3.1. Kërkesa e përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokatët mbrojtës Destan Rukiqi dhe Ymer Osaj në emër të pandehurve **AK1** dhe **AN**, dhe përgjigja e Prokurorit të Shtetit janë paraqitur brenda afatit kohor dhe janë të pranueshme.

3.2. Kolegji i Gjykatës Supreme vëren se aktakuza nuk është ngritur akoma dhe se të pandehurit kanë qenë nën masën e paraburgimit që nga 28 tetori 2013. Sidoqoftë, kolegji nuk pajtohet me avokatët mbrojtës se gjyqtarja e procedurës paraprake ka dështuar që të jap arsye të qarta për vendimin e saj. Në aktvendim janë shtjelluar në detaje pozita e palëve dhe rreziku specifik i arratisjes, ndërhyrjes në prova, pengimit të procedurës penale dhe përsëritjes së veprës penale. Aktvendimi gjithashtu i referohet arsyetimit të dhënë në aktvendimet e

mëparshme dhe vëren se nuk ka pasur ndryshim të rrethanave që nga hera e fundit kur është vazhduar paraburgimi.

3.3. Gjyqtarja e procedurës paraprake në aktvendimin e saj ka adresuar në mënyrë specifike kushtet e nenit 190 paragrafëve 3 dhe 4. Kolegji gjen se kjo pjesë e arsyetimit nuk është abstrakte, e paqartë apo e përmendur në terma të përgjithësuar. Janë dhënë shembuj konkret dhe specifik të ‘kërcënimit të dhunës’ siç kërkohet me nenin 190 (4). Më tutje, shembujt e detajuar në aktvendim përfshinë persona specifik dhe të identifikueshëm ndaj të cilëve ekziston kërcënimi i dhunës. Gjyqtarja e procedurës paraprake gjithashtu ka shqyrtuar plotësisht masat alternative në dispozicion, dhe përsëri ka dhënë arsyet se pse një masë më e butë se paraburgimi nuk do të ishte e mjaftueshme për t’i eliminuar rreziqet.

3.4. Gjykata Supreme gjen se gjyqtarja e procedurës paraprake ka vlerësuar dhe vërtetuar drejtë rrezikun e arratisjes, ndërhyrjes në prova, pengimit të procedurës penale dhe përsëritjes së veprave penale, përveç kushteve të nenit 190 paragrafëve 3 dhe 4 i cili është i zbatueshëm në këtë lëndë.

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Kryetare e kolegjit

Elka Filcheva-Ermenkova
Gjyqtare e EULEX-it

Procesmbajtëse

Kerry Kirsten Moyes
Zyrtare ligjore e EULEX-it

Anëtarët e kolegjit

Esma Erterzi
Gjyqtare e EULEX-it

Emine Mustafa
Gjyqtare e Gjykatës Supreme